



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE TIRANË

Nr. 881 Prot.

Tiranë, më 11/10/2022

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 14, datë 27.5.2021, Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarinë e Ofruesve Publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional", Neni 113, pika "e" shkolla Teknike Ekonomike Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për vitin shkollor 2022-2023 në pozicionet:

- 1 (një) mësimdhënës të kulturës profesionale (teori dhe praktikë profesionale) me kohë të pjesshme në drejtimin *Ekonomi – Biznes*.
- 5 (pesë) mësimdhënës të kulturës profesionale (teori dhe praktikë profesionale) me kohë të pjesshme në drejtimin *Tekstil – Konfeksion* (diplomuar në Inxhinieri Tekstil ose Dizajn mode), që do të mbulojnë ngarkesën mësimore në nivelin pas të mesëm.

1. Kriteret e marrjes në punë:

2.1 Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2.2 Kriteret të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit:

- a) lehtëmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;



- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 19.10.2022

